



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3080/ 9 prot

Datë 29/12/2025

V E N D I M
Nr. 1913/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29/12/2025 u shqyrtua ankesa me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Fusha” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-58761-08-21-2025 me objekt “Shërbimi i Pastrimit në Bashkinë Dimal” me fond limit 127,318,776 (njëqind e njëzet e shtatë milion e treqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Dimal
Adresa: Lagjia “18 Tetori” Ura Vajguore.

Ankimues: Operatori Ekonomik “Rej” SHPK, me NUIS J93711608Q, me adresë rruga “Dritan Hoxha”, Kulla Jeshile ngjitur me shkollën “Ahmet Gashi”, Nr. 8/374/ND+3-6, Tiranë.

Subjekte të Interesuara: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Fusha” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK me NUIS J61922018S dhe K61625001I, me adresë: Rruga “Murat Toptani”, God nr. 3, përball Kinema Millenium dhe adresë: Rruga “Liman Kaba”, Rezidenca Olimpik, Shk. 2, Kati. 4, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”* dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 22.08.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit *“Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”*, me Nr. REF-58761-08-21-2025 me objekt *“Shërbimi i Pastrimit në Bashkinë Dimal”* me fond limit 127,318,776 (njëqind e njëzet e shtatë milion e treqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.

II.2. Në datën 22.09.2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton se në datën 09.10.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit përfundimtar të ofertave si vijon:

- | | | |
|--|---------------------|--------------|
| 1. BOE “Fusha” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK | 102,433,432.08 lekë | kualifikuar |
| 2. “Rej” SHPK | 118,584,347.48 lekë | kualifikuar |
| 3. “Alko Impex Construction” SHPK | 127,308,062.51 lekë | skualifikuar |

II.4. Në datën 20.10.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.5. Në datën 29.10.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6022 dhe nr. 3080/2025 protokoli, datë 30.10.2025 e operatorit ekonomik “Rej” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Fusha” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit me argumentat si vijon:

Së pari, anëtari i BOE, Fusha shpk është kualifikuar në vendin e parë të kësaj procedure prokurimi dhe pas kërkesës së bërë prej autoritetit kontraktor, me qëllim dorëzimin e dokumentacionit origjinal ose të noterizuar, sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 RP të ndryshuar, nuk ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin provues për secilën prej rubrikave të vetëdeklaruar në Formularin Përmbledhës së Vetdeklarimit. Nisur nga procedurat e mëparëshme, kemi vërejtur se ky operator është skualifikuar për mosdorëzimin e dokumentave të vetdeklaruar prej tij në formularin përmbledhës së vetdeklarimit, Shtojca 8.

- Konkretisht, OE Fusha shpk nuk ka dorëzuar dokumentacion provues që operatori i tij ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. (Vertetim i Gjendjes gjyqësore të Subjektit i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve).

- OE Fusha shpk nuk ka dorëzuar dokumentacion provues që operatori i tij ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Së dyti, në pikën 2.3.2, të Kapacitetit Teknik të DT-ve, është përcaktuar, kriteri i mëposhtëm:

2.3.2. *Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit, i cili duhet të jetë i punësuar me kohë të plotë (sipas përcaktimeve të VKM nr.538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të*

perbashkëta).

Për drejtuesin Teknik të kërkuar të paraqitet:

a) Diplomë

b) CV përkatëse

c) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet përkatëse vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Në nenin 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 RR.P.P të ndryshuar, përcaktohet se: 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Operatori Ed Konstruksion shpk ka marrë pjesë në këtë bashkim operatorësh me 24.39 %, ndërsa FUSHA shpk 75.61 %. Në përputhje me përqindjen e deklaruar në BOE, duhej që operatorët ekonomikë të dorëzonin një deklaratë të nënshkruar nga administratori i kompanisë për deklarimin e drejtuesit teknik të shërbimit të pastrimit, i cili duhet të jetë i punësuar me kohë të plotë (sipas përcaktimeve të VKM nr.538 datë 26.05.2009 Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të Biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të perbashkëta. Referuar licencës së subjekti Ed Konstruksion shpk, e cila gjendet e aksesueshme në faqen zyrtare të QKB, Kategoria III.2.B Grumbullim dhe transportim i mbetjeve urbane, drejtues teknik i shërbimit pastrimit, transportit dhe mbetjeve urbane është z. Konalsi Gjoka, por ndërkohë nga administratori i subjektit Ed Konstruksion shpk nuk është deklaruar z. Konalsi Gjoka si drejtues teknik për pastrimin për këtë procedurë prokurimi, duke mos e plotësuar kështu kriterin e pikës 2.3.2 të kapacitetit teknik.

Ndërsa operatori Fusha shpk, referuar faqes zyrtare të QKB, rezulton se drejtues teknik të pastrimit për kategorinë Kategoria III.2.B Grumbullim dhe transportim i mbetjeve urbane, ka znj. Eriselda Zaka. Por referuar deklarimit të administratorit të subjektit Fusha shpk nuk është deklaruar znj. Erikselda Zaka si drejtuese teknike për pastrimin në këtë procedurë prokurimi, duke mos plotësuar në këtë mënyrë kriterin e kërkuar në pikën 2.3.2.

Së treti, në pikën 2.3.3, të Kapacitetit Teknik të DT-ve, të modifikuar, është përcaktuar, kriteri i mëposhtëm:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) me Leje III.B, si më poshtë, të shoqëruara me akt miratimin përkatës.

- Kategoria III.1.B “Për ndikimin në Mjedis”, larje dhe pastrim mjetesish motorike Stacion transferimi për mbetjet jo të rrezikshme.

- Kategoria III.2.B “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve urbane”.

Në nenin 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 RR.P.P të ndryshuar, përcaktohet se: 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Operatori Ed Konstruksion shpk ka marrë pjesë në këtë bashkim operatorësh me 24.39 %, ndërsa Fusha shpk 75.61 %. Nisur nga natyra e shërbimit të kërkuar dhe mjeteve të kërkuara dhe të deklaruara për këtë shërbim, rezulton se nga subjekti Ed Konstruksion shpk nuk është paraqitur licenca e kategorisë III.1.B Për ndikimin në Mjedis, larje dhe pastrim mjetesh motorike Stacion transferimi për mbetjet jo të rrezikshme. Një fakt i tillë është lehtësisht i provueshëm pasi nga verifikimi i faqes zyrtare të QKB rezulton se subjekti Ed Konstruksion shpk nuk e disponon kategorinë e licencës III.1.B Për ndikimin në Mjedis, larje dhe pastrim mjetesh motorike Stacion transferimi për mbetjet jo të rrezikshme. Pavarsisht se Ed Konstruksion shpk ka marrë pjesë si bashkim operatorësh me subjektin Fusha shpk, disponueshmëria e të dyja kategorive të licencave të kërkuara në pikën 2.3.3 ka qënë e detyrueshme për të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve për shkak të zërave të shërbimeve të marra përsipër për tu realizuar respektivisht prej tyre. Por ndërkohë që Fusha shpk disponon të dyja kategoritë e licencave të kërkuara në pikën 2.3.3, një gjë e tillë nuk ndodh me operatorin Ed Konstruksion shpk, i cili disponon vetëm kategorinë e licencës III.2.B, por nuk disponon kategorinë III.1.B. Disponimi i makinerive për pastrim e transport në shërbim të kësaj kontrate e detyron subjektin Ed Konstruksion shpk për disponimin e kategorisë së licencës III.1.B. Sa më sipër kriteri i pikës 2.3.3 nuk është përmbushur dhe BOE duhej skualifikuar.

Së katërti, në pikën 2.3.7, të Kapacitetit Teknik të DT-ve, të modifikuar, është përcaktuar, kriteri i mëposhtëm:

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohet tipi (emërtimi teknik), lloji, marka, nr. i shasisë, viti i prodhimit dhe sasi të përkatëse për mjetet si më poshtë:

a. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet transportues 10 deri në 12 ton, jo më pak se 2 (dy) copë, (në pronësi / me qira / porosi);

b. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet transportues 4-6 ton, jo më pak se 2 (dy) copë, (në pronësi / me qira / porosi);

c. Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, jo më pak se 1 (një) copë, (në pronësi / me qira / porosi);

d. Makina për larjen e rrugëve, (autobot), me kapacitet mbajtës jo më pak se 10000 litra ujë, jo më pak se 2 (dy) copë, (në pronësi / me qira / porosi);

e. Kamioncine me kapacitet transportues 1 deri ne 3.5 ton, per transportimin koshave te vegjel etj, jo më pak se 1 (një) cope, (në pronësi / me qira / porosi);

g. Kamion Veteshkarkues me kapacitet transportues mbi 3.5 ton, per transportimin e inerteve dhe kontenierëve, pa sjellë demtimin e tyre, jo më pak se 2 (dy) copë, (në pronësi / me qira / porosi).

h. Fshese automatike e pajisur me sistem thithës/fryrës dhe me kosh për grumbullimin e mbeturinave, jo më pak se 1 (një) copë, (në pronësi / me qira / porosi).

i. Eskavator për pastrimin, jo më pak se 1 (një) copë, (në pronësi / me qira / porosi).

j. Fadrome per ngarkimin e inerteve, mbeturinave, dherave etj, jo me pak se 1 (një) copë (ne pronësi / me qira / porosi).

Për Mjetet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, çertifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit.*

Për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të shërbimit.

- *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes/fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, si dhe dokumenti me të dhënat teknike të mjetit.*

Për mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të shërbimit.

- *Në rast se mjetet nuk janë në pronësi apo me qera mund të paraqiten Akt Marrëveshje porosie/Kontrate Porosie. Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (original ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit të porositur (emërtimin teknik), llojin, markën,nr. E shasisë, vitin e prodhimit, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë.*

- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fitues.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku lejon AK të verifikojë mjetet dhe pajisjet para shpalljes së fituesit dhe gjatë zbatimit të kontratës.*

Në nenin 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 RR.P.P të ndryshuar, përcaktohet se: 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Operatori Ed Konstruksion shpk ka marrë pjesë në këtë bashkim operatorësh me 24.39 %, ndërsa Fusha shpk 75.61 %. Në përputhje me përqindjen e deklaruar në BOE dhe zërave të punimeve të marra përsipër për të realizuar, rezulton se anëtari i BOE Ed Konstruksion shpk nuk disponon minimalisht 1 makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet transportues 10 deri në 12 ton. Referuar makinave dhe mjeteve të deklaruara në QKB nuk rezulton që të jetë e deklaruar një makinë e tillë teknologjike nga ana e Ed Konstruksion shpk. Në përputhje me përqindjen e deklaruar në BOE dhe zërave të punimeve të marra përsipër për të realizuar, rezulton se anëtari i BOE Ed Konstruksion shpk nuk disponon minimalisht 1 makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet transportues 4-6 ton. Referuar makinave dhe mjeteve të deklaruara në QKB nuk rezulton që të jetë e deklaruar një makinë e tillë teknologjike nga ana e Ed Konstruksion shpk. Në përputhje me përqindjen e deklaruar në BOE dhe zërave të punimeve të marra përsipër për të realizuar, rezulton se anëtari i BOE Ed Konstruksion shpk nuk disponon minimalisht 1 Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, Referuar makinave dhe mjeteve të deklaruara në QKB nuk rezulton që të jetë e deklaruar një makinë e tillë teknologjike nga ana e Ed Konstruksion shpk.

Në përputhje me përqindjen e deklaruar në BOE dhe zërave të punimeve të marra përsipër për të realizuar, rezulton se anëtari i BOE Ed Konstruksion shpk nuk disponon minimalisht 1 Makina për larjen e rrugëve, (autobot), me kapacitet mbajtës jo më pak se 10000 litra ujë. Referuar makinave dhe mjeteve të deklaruara në QKB nuk rezulton që të jetë e deklaruar një makinë e tillë teknologjike nga ana e Ed Konstruksion shpk.

Në përputhje me përqindjen e deklaruar në BOE dhe zërave të punimeve të marra përsipër për të realizuar, rezulton se anëtari i BOE Ed Konstruksion shpk nuk disponon minimalisht 1 Fshese automatike e pajisur me sistem thithës/fryrës dhe me kosh për grumbullimin e mbeturinave, Referuar makinave dhe mjeteve të deklaruara në QKB nuk rezulton që të jetë e deklaruar një makinë e tillë teknologjike nga ana e Ed Konstruksion shpk.

Autoriteti kontraktor gjatë fazës së vlerësimit të ofertave ka neglizhaur të vlerësojë deklaratimet e mjeteve të deklaruara nga Ed Konstruksion shpk dhe Fusha shpk në përputhje me përqindjen

e deklaruar në BOE dhe zërat e punimeve të marra përsiëpër për të realizuar. Si duket për autoritetin kontraktor më shumë rendësi ka patur disponimi i këtyre mjeteve të marra së bashku si bashkim operatorësh, por kurrësesi në raport me parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021. Një vlerësim i tillë, aspak objektiv, ka sjellë si pasojë një trajtim të pabarabartë mes operatorëve ekonomik në drejtim të plotësimit të kërkesave të tenderit duke shkelur në këtë mënyrë parimin e trajtimit të barabartë.

Ndërsa operatori Fusha shpk nuk ka dorëzuar asnjë prej dy deklaratave të kërkuara në pikën 2.3.7: - Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fitues. - Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku lejon AK të verifikojë mjetet dhe pajisjet para shpalljes së fituesit dhe gjatë zbatimit të kontratës.

Mos dorëzimi i të dyja këtyre deklaratave nga subjekti Fusha shpk ka ardhur për arsye se të gjitha mjetet e kësaj shoqërie janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe për arsyen e penalitetit të mundëshëm në rastin e konstatimit të dorëzimit të një deklarate ku pretendohet se mjetet janë të paangazhuara kur ndërkohë rezulton krejt e kundërta.

Së pesti: Bashkëlidhur dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka publikuar preventivin dhe analizat e preventivit për tu plotësuar nga operatorët bashkë me shtojcën 1, Formularin e ofertës. Bashkëlidhur preventivit, gjenden dhe 9 analiza kosto të cilat janë të detyrueshme për tu plotësuar nga operatorët garues në tender. Nga ana e BOE Ed Konstruksion shpk dhe Fusha shpk nuk është dorëzuar bashkë me preventivin dhe analiza e 9 kostove për këtë shërbim, pasi nëse do ishte dorëzuar kjo analizë dhe do ishte dorëzuar në përputhje të plotë me parashikimet e legjislacionit në fuqi, oerta e BOE Ed Konstruksion shpk dhe Fusha shpk kurësesi nuk do të ishte aq e ulët.

Sa më sipër perfundimisht kërkojmë:

A-) Pranimin e ankesës

B-) Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi kualifikimin e BOE Ed Konstruksion shpk dhe Fusha shpk, duke i skualifikuar ato.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprahe” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 3080/1 prot, datë 31.10.2025 me kriteret që operatori ekonomik “Rej” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Fusha” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK, të parashtruara në ankesën me nr. 3080 prot, datë 29.10.2025.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor u konstatua se, pranë Komisionit Prokurimit Publik është protokolluar formulari argumentave nr 3080/2 prot, datë 05.11.2025

nga subjekti i interesuar “Ed Konstruksion” SHPK, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

II.8. Me shkresën nr. 2222/28 prot, datë 07.11.2025, me objekt “Kthim përgjigje ankesës A/2025/6022, datë 30.10.2025”, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 3080/3 prot., datë 10.11.2025 autoriteti kontraktor Bashkia Dimal ka dërguar vendimin e KSHA-së, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK. Referuar Vendimit të KSHA-së rezulton se pretendimet e ankimuesit janë refuzuar.

II.9. Me qëllim shqyrtimin e ankesës e operatorit ekonomik ankimues, me anë të shkresës nr. 3080/4 prot., datë 20.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor që të dërgojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoriteti kontraktor nga bashkimi i operatorëve ekonomikë i kualifikuar i par, në lidhje me vërtetueshmërinë e deklarimeve në shtojcën 10 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sikurse përcaktohet në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 të VKM 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar.

II.10. Me shkresën nr. 3558/1 prot, datë 25.11.2025, me objekt “Dërgim dokumentacioni në lidhje me procedurën Shërbimi i Pastrimit në Bashkinë Dimal”, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 3080/5 prot., datë 26.11.2025 autoriteti kontraktor Bashkia Dimal ka dërguar informacion dhe dokumentacion në zbatim të shkresës nr. 3080/4 prot, datë 20.11.2025 të Komisionit Prokurimit Publik.

II.11. Me shkresën nr. 3558/2 prot, datë 11.12.2025, me objekt “Kërkesë për shpejtim të përgjigjes përfundimtare në lidhje me procedurën e Shërbimit të Pastrimit në Bashkinë Dimal”, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 3080/6 prot, datë 12.12.2025, Bashkia Dimal kërkon përshpejtimin e vendimarrjes për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Rej” SHPK se: *“Anëtari i BOE, Fusha shpk është kualifikuar në vendin e parë të kësaj procedure prokurimi dhe pas kërkesës së bërë prej autoritetit kontraktor, me qëllim dorëzimin e dokumentacionit origjinal ose të noterizuar, sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 RP të ndryshuar, nuk ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin provues për secilën prej rubrikave të vetëdeklaruara në Formularin Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Nisur nga procedurat e mëparshme, kemi vërejtur se ky operator është skualifikuar për mosdorëzimin e dokumentave të vetëdeklaruara prej tij në formularin përmbledhes së vetëdeklarimit, Shtojca 8. - Konkretisht, OE Fusha shpk nuk ka dorëzuar dokumentacion provues që operatori i tij ekonomik nuk është*

dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. (Vertetim i Gjendjes gjyqësore të Subjektit i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve). - OE Fusha shpk shpk nuk ka dorëzuar dokumentacion provues që operatori i tij ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, gërma “e” e dokumentave të procedurës së prokurimit, është parashikuar si vijon:

Ofertuesi deklaron se:

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

[...]

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

III.1.2. Në shtojcën 10 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, ndër të tjera, parashikohet se:

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme_____.

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme_____.

III.1.3. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar fizikisht nga autoritetit kontraktor si dhe dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, konstatohet se bashkimi i operatorëve ekonomik “Fusha” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK ka dorëzuar:

- Shtojca 10 Formulari Përmbledhës Vetëdeklarimit i plotësuar në të gjitha fushat i firmosur dhe vulosur.

- Dokumentacioni fizik i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Fusha” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe ardhur me shkresën nr. 3558/1 prot, datë 25.11.2025 protokolluar me tonën me nr. 3080/5 prot datë 26.11.2025, autoriteti

kontraktor ka dërguar dokumentacionin e dorëzuar nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Fusha” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK, ku ndër të tjera është dorëzuar edhe dokumenti: Vërtetim debie nr. OSHEE-2025-6325767-EC, datë 03.09.2025, ku citohet: [...] Bazuar në deklaratimet e deklaruesit...z. SH. F, vërtetohet se kërkuksi Fusha SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratat, (me kod) TR3VXXXXXXXX693, TR2TXXXXXXXX719, TR1OXXXXXXXX724, TR1OXXXXXXXX720, AL00XXXX14, TR3MXXXXXXXX477, TR1OXXXXXXXX417, TR1OXXXXXXXX415, TR2AXXXXXXXX203, AL00XXXX63, AL01XXXX57, TR1OXXXXXXXX416, AL00XXXX57, AL00XXXX14, TR3MXXXXXXXX403, TR3MXXXXXXXX385, VL03MXXXXXXXX415, TR1OXXXXXXXX551, TR3MXXXXXXXX476, AL00XXX43, TR3MXXXXXXXX541, TR1BXXXXXXXX198, TR3MXXXXXXXX384, TR1OXXXXXXXX715, TR1BXXXXXXXX368, TR1OXXXXXXXX719, DU1EXXXXXXXX883, AL00XXXX17, TR1OXXXXXXXX986, TR1OXXXXXXXX714, TR2AXXXXXXXX216, titullar/përdorues i të cilave është Fusha SHPK, rezulton te kete ne total 0 lekë detyrime per faturat e energjiise elektrike, vlere e llogaritur deri me daten 03.09.2025 përfshirë faturën koherente të muajt Gusht 2025.

- Vërtetim i Gjëndjes Gjyqësore nr. 11 prot, datë 25.08.2025 për subjektin Fusha SHPK me NIPT J61922018S, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve rezulton se ky subjekt është i Pa Dënuar.

III.1.4 . Në nenin 76 pika , pika 1, të ligjit 162/2020 të LPP-së përcaktohet se: “Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) falsifikim;
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

III.1.5. Në nenin 77 pika 1 të ligjit 162/2020 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.6. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurë.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

- a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;
- b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”

III.1.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i

ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi¹⁹;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.8 Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstaton se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Fusha” SHPK & “Ed Konstruktion” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën II, A, parashikohet “Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme”. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Fusha” SHPK & “Ed Konstruktion” SHPK, si dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor nëpërmjet shkresës nr. prot 3558/1 prot, datë 25.11.2025, protokolluar në KPP me nr. 3080/5, datë 26.11.2025, gjithsej 1613 faqe. Referuar pretendimeve të ankimuesit, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Fusha” SHPK &

“Ed Konstruksion” SHPK nuk ka dorëzuar dokumentacion provues që operatori tij ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e enregjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit sipas legjislacionit në fuqi, Komisioni i Prokurimit Publik pasi verifikoi dokumentacionin e ardhur nga autoriteti kontraktor konkretisht “Vërtetim debie nr. OSHEE-2025-6325767-EC, datë 03.09.2025, ku citohet: [...] Bazuar në deklaratimet e deklaruesit...z. SH. F, vërtetohet se kërkuksi Fusha SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratat, (me kod) TR3VXXXXXXXXX693, TR2TXXXXXXXXX719, TR1OXXXXXXXXXXXX724, TR1OXXXXXXXXXXXX720, AL00XXXXXXXXXX14, TR3MXXXXXXXXXXXX477, TR1OXXXXXXXXXXXX417, TR1OXXXXXXXXXXXX415, TR2AXXXXXXXXXXXX203, AL00XXXX63, AL01XXXX57, TR1OXXXXXXXXXXXX416, AL00XXXX57, AL00XXXX14, TR3MXXXXXXXXXXXX403, TR3MXXXXXXXXXXXX385, VL03MXXXXXXXXXXXX415, TR1OXXXXXXXXXX551, TR3MXXXXXXXXXX476, AL00XXX43, TR3MXXXXXXXXXXXX541, TR1BXXXXXXXXXXXX198, TR3MXXXXXXXXXXXX384, TR1OXXXXXXXXXXXX715, TR1BXXXXXXXXXXXX368, TR1OXXXXXXXXXXXX719, DU1EXXXXXXXXXX883, AL00XXXX17, TR1OXXXXXXXXXX986, TR1OXXXXXXXXXX714, TR2AXXXXXXXXXX216, titullar/përdorues i të cilave është Fusha SHPK, rezulton te kete ne total 0 lekë detyrime per faturat e energjise elektrike, vlere e llogaritur deri me daten 03.09.2025 përfshirë faturën koherente të muajt Gusht 2025”, si dhe pretendimeve të ankimesit, rezulton se bashkalidhur vërtetimit të sipërcituar nga ana e FSHU (Furnizuesi i Shërbimit Universal) është dorëzuar dhe lista e kontratave e cila në total rezulton se subjekti “Fusha” SHPK ka 31 kontrata aktive me OSHE, për të cilat referuar vërtetimit të sipërcituar rezulton se nuk ka detyrime të papaguara duke përfshirë edhe faturën e muajt Gusht 2025.

III.1.9. Në nenin 11 (Leximi i Matësit dhe Faturimi i Energjisë Elektrike), paragrafi 11.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: “11.1 Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të Klientit, konform parashikimeve të Kodit të Matjes, Kodit të Rrjetit si dhe legjislacionit në fuqi për Metrologjinë, për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike dhe do ti dërgojë Klientit fundor në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit.”

III.1.10 Në nenin 13 (Pagesa dhe afati për kryerjen e saj), paragrafi 13.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: “13.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse.”

III.1.11 KPP, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë tij, si dhe duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi, lidhur me një nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimes, në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës, dhe pasi verifikoi dokumentacion e dorëzuar nga autoriteti kontraktor konkretisht dokumentin “Vërtetim debie nr. OSHEE-2025-6325767-EC, datë

03.09.2025, ku citohet: [...] Bazuar në deklaratimet e deklaruesit...z. SH. F, vërtetohet se kërkesa Fusha SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratat, (me kod) TR3VXXXXXXXXX693, TR2TXXXXXXXXX719, TR1OXXXXXXXXX724, TR1OXXXXXXXXX720, AL00XXXXX14, TR3MXXXXXXXXXXXX477, TR1OXXXXXXXXXXXX417, TR1OXXXXXXXXXXXX415, TR2AXXXXXXXXXXXX203, AL00XXXXX63, AL01XXXXX57, TR1OXXXXXXXXXXXX416, AL00XXXXX57, AL00XXXXX14, TR3MXXXXXXXXXXXX403, TR3MXXXXXXXXXXXX385, VL03MXXXXXXXXXXXX415, TR1OXXXXXXXXXXXX551, TR3MXXXXXXXXXXXX476, AL00XXXXX43, TR3MXXXXXXXXXXXX541, TR1BXXXXXXXXXXXX198, TR3MXXXXXXXXXXXX384, TR1OXXXXXXXXXXXX715, TR1BXXXXXXXXXXXX368, TR1OXXXXXXXXXXXX719, DU1EXXXXXXXXX883, AL00XXXXX17, TR1OXXXXXXXXX986, TR1OXXXXXXXXX714, TR2AXXXXXXXXX216, titullar/përdorues i të cilave është Fusha SHPK, rezulton të kete ne total 0 lekë detyrime per faturat e energjise elektrike, vlere e llogaritur deri me daten 03.09.2025 përfshirë faturën koherente të muajt Gusht 2025”. Referuar informacionit të dhënë nga Furnizuesi Shërbimit Universal Sh.A., i cili menaxhon sistemin e të dhënave për pagimin e energjisë elektrike për të gjithë subjektet përdoruese të energjisë elektrike, për të gjithë kontratat e lidhura midis Furnizuesit të Shërbimit Universal SHA dhe subjekteve përdoruese të energjisë elektrike, me anë të së cilës vërtetohet, se subjekti “Fusha” SHPK nuk rezulton debitor për të 31 kontratat, përfshirë edhe muajin e fundit të maturuar, referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit. Komisioni Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “Fusha” SHPK anëtar i BOE me dokumentacionin e dorëzuar në autoriteti kontraktor, i cili shërben si provë për vertetimin e deklaratimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, i përmush kërkesat e autoritetit kontraktor. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar për përmushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, anëtar i BOE operatori ekonomik “Fusha” SHPK ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, të pikës 2, të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dokumente të cilat autoriteti kontraktor i ka vënë në dispozicion të KPP-së, nga verifikimi i të cilave rezulton se operatori ekonomik “Fusha” ShPK i përmbush kërkesat e autoritetit kontraktor.

Gjithashtu nisur nga pretendimet më sipër të ankimesit, për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomik “Fusha” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK, për shkak se anëtar i BOE operatori ekonomik “Fusha” SHPK nuk ka dorëzuar dokumentacion provues që operatori i tij ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale (Vërtetim i Gjëndjes Gjyqësore të Subjektit i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve). Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Fusha” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të firmosur dhe vulosur, ku për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit ka kryer deklaratimet në cdo fushë të tij. Duke qenë se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Fusha” SHPK & “Ed Konstruksion”, sipas vendimit të KVO-së është operatori ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”

dhe “j”, të pikës 2, të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dokumente të cilat autoriteti kontraktor i ka vënë në dispozicion të KPP-së me shkresën nr. 3558/1 prot, datë 25.11.2025 me lëndë “*Dërgim dokumentacioni*”, protokolluar me tonën me nr. 3080/5 datë 26.11.2025, bashkë me dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, në brendësi të të cilit gjendet dokumentecioni për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit objekt ankese si më poshtë: “*Vërtetim i Gjëndjes Gjyqësore nr. 11 prot, datë 25.08.2025 për subjektin Fusha SHPK me NIPT J61922018S, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve rezulton se ky subjekt është i Pa Dënuar*”. Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit, dhe duke i ballafaquar me kriteret e përgjithshme të kualifikimit, dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Fusha” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK, si dhe dokumentacionin fizik të paraqitur nga BOE pranë autoritetit kontraktor për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, KPP gjykon, se anëtari i BOE operatori ekonomik “Fusha” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar në autoritetin kontraktor, i cili shërben si provë për vërtetimin e deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, i përmbush kërkesat e autoritetit kontraktor. Komisioni vëren, se anëtari i BOE operatori ekonomik “Fusha” SHPK ka dorëzuar Vërtetimet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për subjektin që nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së. Sa më lart KPP gjykon se operatori ekonomik “Fusha” SHPK ka plotësuar rubrikën Pjesa II Shkaqet e përjashtimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit lidhur me plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit duke dhënë informacionin që ky formular kërkon, si dhe ka paraqitur dokumentacion për këtë kriter pranë autoritetit kontraktor referuar informacionit të këtij të fundit.

Në këtë kuadër, anëtari i BOE operatori ekonomik “Fusha” SHPK ikualifikuar i pari, nga verifikimi i dokumentacionit provues të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit të cilat si më sipër kanë shëbryer si objekt i ankesës dhe nga deklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për përmbushjen e këtyre kriterëve, konsiderohet dokumentacion i vlefshëm, duke përmbushur kërkesat e autoritetit kontraktor.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Rej” SHPK se: “*Së treti, në pikën 2.3.3, të Kapacitetit Teknik të DT-ve, të modifikuar, është përcaktuar, kriteri i mëposhtëm: 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) me Leje III.B, si më poshtë, të shoqëruara me akt miratimin përkatës. - Kategoria III.1.B “Për ndikimin në Mjedis”, larje dhe pastrim mjetesish motorike Stacion transferimi për mbetjet jo të rrezikshme. - Kategoria III.2.B “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve urbane*”. Në nenin 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 RR.P.P të ndryshuar, përcaktohet se: 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në

aktmarrëveshje. Operatori Ed Konstruksion shpk ka marrë pjesë në këtë bashkim operatorësh me 24.39 %, ndërsa Fusha shpk 75.61 %. Nisur nga natyra e shërbimit të kërkuar dhe mjeteve të kërkuara dhe të deklaruara për këtë shërbim, rezulton se nga subjekti Ed Konstruksion shpk nuk është paraqitur licenca e kategorisë III.1.B Për ndikimin në Mjedis, larje dhe pastrim mjetesh motorike Stacion transferimi për mbetjet jo të rrezikshme. Një fakt i tillë është lehtësisht i provueshëm pasi nga verifikimi i faqes zyrtare të QKB rezulton se subjekti Ed Konstruksion shpk nuk e disponon kategorinë e licencës III.1.B Për ndikimin në Mjedisë, larje dhe pastrim mjetesh motorike Stacion transferimi për mbetjet jo të rrezikshme. Pavarsisht se Ed Konstruksion shpk ka marrë pjesë si bashkim operatorësh me subjektin Fusha shpk, disponueshmëria e të dyja kategorive të licencave të kërkuara në pikën 2.3.3 ka qënë e detyrueshme për të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve për shkak të zërave të shërbimeve të marra përsipër për tu realizuar respektivisht prej tyre. Por ndërkohë që Fusha shpk disponon të dyja kategoritë e licencave të kërkuara në pikën 2.3.3, një gjë e tillë nuk ndodh me operatorin Ed Konstruksion shpk, i cili disponon vetëm kategorinë e licencës III.2.B, por nuk disponon kategorinë III.1.B. Disponimi i makinerive për pastrim e transport në shërbim të kësaj kontrate e detyron subjektin Ed Konstruksion shpk për disponimin e kategorisë së licencës III.1.B. Sa më sipër kriteri i pikës 2.3.3 nuk është përmbushur dhe BOE duhej skualifikuar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 9/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.3 “Kapacitetin teknik”, e modifikuar të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) me Leje III.B, si më poshtë, të shoqëruara me akt miratimin përkatës.

- *Kategoria III.1.B “Për ndikimin në Mjedis”, larje dhe pastrim mjetesh motorike Stacion transferimi për mbetjet jo të rrezikshme.*

- *Kategoria III.2.B “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve urbane”.*

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Fusha” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- *Marrëveshje për Bashkëpunim lidhur ndërmjetë shoqërive “Fusha” SHPK me “Ed Konstruksion” SHPK më datë 22.09.2025, ku secila do të kontribuojë në masën 75.61 % “Fusha” SHPK, dhe në masën 24.39 % “Ed Konstruksion” SHPK (Neni 2 – Detyrimet e Shoqërive), duke marrë përsipër të realizojë punët sipas preventivit bashkalidhur kontratës së bashkëpunimit.*

- *Licencë LN-5802-05-2023, Kodi III.2.B, emërtimi përshkrues i veprimtarisë “Grumbullim transportim, ruajtje i mbetjeve jo të rrezikshme dhe të rrezikshme”, për subjektin “Fusha”*

SHPK, shoqëruar me Akt-Miratimmi nr. 3419 prot., datë 26.05.2023 për kodet (16 01 03, 13 02 04, 13 02 05, 13 02 06, 13 02 07, 13 02 08, 13 07 01, 13 07 02, 13 07 03, 16 01 07, 16 01 13, 20 01 01, 20 03 01).

- Leje, PN-8343-04-2019, Kodi III.1.B, emërtimi përshkrues i veprimtarisë “Leje Mjedisi e tipit B për: Përzierja e imentos ose përdorimi i imentos në masë të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e imentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të imentos. Prerja, gdhendja dhe lustrimi i gurit. Larje dhe pastrim mjeteve motorike. ID 5.4/c Rikuperim i mbetjeve jot ë rrezikshme a. Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lartë. ID 5.10/b. Stacion transferimi për mbetje jot ë rrezikshme që nuk përmendet më lartë”, për subjektin “Fusha” SHPK, shoqëruar me Akt-Miratimmi nr. 3174 prot., datë 10.05.2024.

- Leje, Kodi III.1.A, emërtimi përshkrues i veprimtarisë “Leje Mjedisi e tipit C për Furnizim me karburant I makinave në një stacion të furnizimit me karburant. Riparim I pajisjeve motorike dhe motocikletave. Larje dhe pastrim mjeteve motorike”, për subjektin “Fusha” SHPK, shoqëruar me Akt-Miratimmi nr. 217 prot., datë 04.04.2019.

- Licencë LN-5442-07-2018, Kodi III.2.B, emërtimi përshkrues i veprimtarisë “Grumbullim, ruajtje dhe transportin i mbetjeve urbane”, për subjektin “Ed Konstruksion” SHPK, shoqëruar me Akt-Miratimmi nr. 5625 prot., datë 02.07.2018 për kodet (20 01 01, 20 01 02, 20 01 08, 20 01 11, 20 01 39, 20 01 40, 20 02 01, 20 03 01, 20 03 02, 20 03 03, 20 03 07).

- Licencë LN-5760-08-2018, Kodi III.2.B, emërtimi përshkrues i veprimtarisë “Grumbullim dhe transportin i mbetjeve të dherave”, për subjektin “Ed Konstruksion” SHPK, shoqëruar me Akt-Miratimmi nr. 6936 prot., datë 23.08.2018 për kodet (17 01 01, 17 01 02, 17 01 03, 17 01 07, 17 05 04, 17 05 06, 17 05 08, 17 06 04, 17 08 02, 17 09 04).

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit public.

III.2.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet

kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisorsocial e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.2.6. Neni 41 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. 4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme 41stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

III.2.7. Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “Secili prej

anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPPsë, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.2.8. Në seksionin Kategoria III.1. “Për Ndikimin në Mjedis”, nënseksioni “Licencimi i kategorisë III.1.B”, pika 2 dhe 4 të Vendimit nr. 538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashëkta”, të ndryshuar parashikohet se: 2. “Lejet e ndikimit në mjedis ndahen në tre nënkategori si vijon: a) “Leje e thjeshte mjedisore” me kodin III.1.A; b) “leje mjedisore” me kodin III.1.B; c) “leje e integruar mjedisore” me kodin III.1.C. 4. Leja e nënkategorive A, B, C, trajtohen sipas grupit III. Dokumentet provuese e shoqëruese që dorëzohen nga kërkuuesi, kuptimi i llojit të veprimtarive dhe i ndikimit të tyre në mjedis, institucioni tjetër, procedura e shqyrtimit të kërkesë prej tij dhe afatet për t’iu përgjigjur QKL-së për një kërkesë që ka kaluar fazën e parë nga QKL, për nënkategoritë A, B, C janë ato respektivet e përcaktuara nga ligji nr.8934, datë 5.9.2002 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar, dhe aktet nën/ligjore në zbatim të tij.”.

III.2.9. Në seksionin Kategoria III.2. “Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, nënseksioni “Licencimi i kategorisë III.2.B”, pika 8 dhe 9 të Vendimit nr. 538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashëkta”, të ndryshuar parashikohet se: “Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. 9. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

III.2.10. Në Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, në nenin 1 dhe 2 “Qëllimi dhe Objekti”, parashikohet shprehimisht: “Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës”. Ky ligj përcakton: a) rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë; b) masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë.

III.2.11. Në shtojcën 1, pika 20 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 402, Datë 30.06.2021 “Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve”, përcaktohet: “17 Mbetjet Urbane (Mbetjet Shtëpiake Dhe Tregtare, Mbetje Industriale e Institucionale të Ngjashme) Përfshirë Fraksionet e Mbledhura Veçmas)”.

20 01 Fraksionet e ndara (përveç 15 01)
 20 01 01 Letër dhe karton
 20 01 02 Qelq
 20 01 08 Mbetje të biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat
 20 01 10 Veshjet
 20 01 11 Tekstilet
 20 01 13 * Tretësit
 20 01 14 * Acidet
 20 01 15 * Bazat
 20 01 17 * Fotokimikatet
 20 01 19 * Pesticidet
 20 01 21 * Mbetje të tubave fluoreshente dhe mbetje të tjera që përmbajnë merkur
 20 01 23 * Pajisje skarco që përmbajnë klorofluorokarbone
 20 01 25 Vajra dhe dhjamëra ushqimore
 20 01 26 * Vajra dhe dhjamëra, të tjera nga ato të përmendura në 20 01 25
 20 01 27 * Bojëra, ngjyra, ngjitës etj., që përmbajnë substanca të rrezikshme
 20 01 28 Bojëra, ngjyra, ngjitës etj., të tjera nga ato të përmendura në 20 01 27
 20 01 29 * Detergjent që përmbajnë substanca të rrezikshme
 20 01 30 Detergjent të tjerë nga ato të përmendur në 20 01 29
 20 01 31 * Medikamente citotoksike dhe citostatike
 20 01 32 Medikamente të tjera nga ato të përmendura në 20 01 31
 20 01 33 * Bateritë dhe akumulatorët të përfshirë në 16 06 01, 16 06 02 ose 16 06 03 dhe bateritë e akumulatorët e pandarë
 20 01 34 Bateritë dhe akumulatorët e tjerë nga ato të përmendur në 20 01 33
 20 01 35 * Pajisjet e skaduara elektrike dhe elektronike, të tjera nga ato të përmendura në 20 01 21 dhe 20 01 23 që përmbajnë komponentë të rrezikshëm
 20 01 36 Pajisjet e skaduara elektrike dhe elektronike, të tjera nga ato të përmendura në 20 01 21, 20 01 23 dhe 20 01 35
 20 01 37 * Mbetje druri që përmbajnë substanca të rrezikshme
 20 01 38 Mbetje druri të tjera nga ato të përmendura në 20 01 37
 20 01 39 Plastikët
 20 01 40 Metalet
 20 01 41 Mbetjet nga pastrimi i oxhaqeve
 20 01 99 Fraksione të tjera të paspecifikuara
 20 02 Mbetjet e kopshteve dhe parqeve (përfshirë mbetjet e varrezave)
 20 02 01 Mbetje të biodegradueshme
 20 02 02 Dhera dhe gurë
 20 02 03 Mbetje të tjera të pabiodegradueshme
 20 03 Mbetje të tjera urbane
 20 03 01 Mbetjet e përziera urbane
 20 03 02 Mbetje nga tregjet
 20 03 03 Mbetje nga pastrimi i rrugëve
 20 03 04 Llumra nga gropat septike
 20 03 06 Mbetje nga pastrimi i ujërave të zeza

20 03 07 Mbetjet të vëllimshme

20 03 99 Mbetjet urbane të paspecifikuara

III.2.12. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Fusha” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK, Komisioni konstaton, se ky bashkim operatorësh ekonomikë ka ngarkuar në SPE dokumentacionin si vijon:

- Marrëveshje për Bashkëpunim lidhur ndërmjetë shoqërive “Fusha” SHPK me “Ed Konstruksion” SHPK më datë 22.09.2025, ku secila do të kontribuojë në masën 75.61 % “Fusha” SHPK, dhe në masën 24.39 % “Ed Konstruksion” SHPK (Neni 2 – Detyrimet e Shoqërive), duke marrë përsipër të realizojë punët sipas preventivit bashkalidhur kontratës së bashkëpunimit.

- Licencë LN-5802-05-2023, Kodi III.2.B, emërtimi përshkrues i veprimtarisë “Grumbullim transportim, ruajtje i mbetjeve jo të rrezikshme dhe të rrezikshme”, për subjektin “Fusha” SHPK, shoqëruar me Akt-Miratimmi nr. 3419 prot., datë 26.05.2023 për kodet (16 01 03, 13 02 04, 13 02 05, 13 02 06, 13 02 07, 13 02 08, 13 07 01, 13 07 02, 13 07 03, 16 01 07, 16 01 13, 20 01 01, 20 03 01).

- Leje, PN-8343-04-2019, Kodi III.1.B, emërtimi përshkrues i veprimtarisë “Leje Mjedisi e tipit B për: Përzierja e imentos ose përdorimi i imentos në masë të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e imentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të imentos. Prerja, gdhendja dhe lustrimi i gurit. Larje dhe pastrim mjeteve motorike. ID 5.4/c Rikuperim i mbetjeve jot të rrezikshme a. Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lartë. ID 5.10/b. Stacion transferimi për mbetje jot të rrezikshme që nuk përmendet më lartë”, për subjektin “Fusha” SHPK, shoqëruar me Akt-Miratimmi nr. 3174 prot., datë 10.05.2024.

- Leje, Kodi III.1.A, emërtimi përshkrues i veprimtarisë “Leje Mjedisi e tipit C për Furnizim me karburant I makinave në një stacion të furnizimit me karburant. Riparim I pajisjeve

motorike dhe motocikletave. Larje dhe pastrim mjetesh motorike”, për subjektin “Fusha” SHPK, shoqëruar me Akt-Miratimmi nr. 217 prot., datë 04.04.2019.

- Licencë LN-5442-07-2018, Kodi III.2.B, emërtimi përshkrues i veprimtarisë “Grumbullim, ruajtje dhe transportin i mbetjeve urbane”, për subjektin “Ed Konstruksion” SHPK, shoqëruar me Akt-Miratimmi nr. 5625 prot., datë 02.07.2018 për kodet (20 01 01, 20 01 02, 20 01 08, 20 01 11, 20 01 39, 20 01 40, 20 02 01, 20 03 01, 20 03 02, 20 03 03, 20 03 07).

- Licencë LN-5760-08-2018, Kodi III.2.B, emërtimi përshkrues i veprimtarisë “Grumbullim dhe transportin i mbetjeve të dherave”, për subjektin “Ed Konstruksion” SHPK, shoqëruar me Akt-Miratimmi nr. 6936 prot., datë 23.08.2018 për kodet (17 01 01, 17 01 02, 17 01 03, 17 01 07, 17 05 04, 17 05 06, 17 05 08, 17 06 04, 17 08 02, 17 09 04).

Dokumentacioni i sipërcituar është dorëzuar në kuadër të vërtetueshmërisë për plotësimin e kriterit të vecantë të kualifikimit, në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik në shtojcën 9/2. Ligji për Prokurimin Publik (LPP) në nenin 14, pika 2 e tij ka parashikuar edhe mënyrën e paraqitjes së ofertës nga grupe operatorësh ekonomikë si një kandidat i vetëm. Nga LPP është bërë rregullimi me akt nënligjor i paraqitjes së ofertës nga një bashkim operatorësh ekonomikë dhe është pikërisht neni 83, i VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili i jep mundësinë operatorëve ekonomikë për paraqitjen e ofertës si një bashkim operatorësh ekonomikë, duke përcaktuar pjesën e punës, shërbimit ose mallit, që do të kryej secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Në pikën 3, të po këtij neni, përcaktohet edhe mënyra e përmbushjes së kriterëve nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë. Në rastin konkret bashkimi i operatorëve ekonomikë “Fusha” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar: *Marrëveshje për Bashkëpunim të datës 22.09.2025, ndërmjet shoqërive “Fusha” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK, ku secila do të kontribuojë në masën 75.61 % e “Fusha” SHPK, në masën 24.39 % e “Ed Konstruksion” SHPK në këtë pjesëmarrje (Neni 2-Pjesëmarrja), duke marrë përsipër të realizojë punët sipas preventivit bashkangjitur. Në neni 88, pika 3 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Referuar kriterit të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik, KPP konstaton se është kërkuar paraqitja e lejes/licencës *Kategoria III.1.B “Për ndikimin në Mjedis”, larje dhe pastrim mjetesh motorike Stacion transferimi për mbetjet jo të rrezikshme. - Kategoria III.2.B “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve urbane”*.. Megjithëse nga bashkimi i operatorëve është përcaktuar ndarja e punimeve të gjithë zërave të preventivit dhe sasia/volumi në %, ku konstatohet se secili prej anëtarëve të BOE ka marrë përsipër të kryejë shërbimet përkatëse si grumbullim dhe transportim mbeturina sipas të dhënave të deklaruara në kontratën e bashkëpunimit, nga dokumentacioni teknik, konkretisht atyre të licencave të lëshuara nga QKL me kodin III.1.B në përmbushje të kriterit 2.3.3 të kapacitetit teknik, Komisioni konstaton se anëtari i BOE “Ed Konstruksion” SHPK në*

dokumenatcionin e dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se nuk ka paraqitur leje mjedisore III.1.B. Për më tepër, nga një hetim në burime të hapura në faqen zyrtare të QKB, Komisioni konstaton, se ky operator ekonomik nuk është i pajisur me Leje Mjedisore me kodin III.1.B, sikurse është kërkuara në përmbushje të kriterit 2.3.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Fusha” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK nuk është në kushtet e përmbushjes së kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit objekt – ankimi sa i takon kërkesës për disponimin e lejes mjedisore me Kod III.1.B, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit, zërave të shërbimit në përputhje me nenin 88 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Në mënyrë eksplicite, ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit, të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, por cënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

III.2.13. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e 25 përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtë për drejtë me kriterin e vendosur. Sa më sipër, KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar dokumentet e tenderit të mësipërm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e kualifikimit nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe t’i japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se anëtarë i BOE operator ekonomik “Ed Konstruksion” SHPK me dokumentacionin e paraqitur nuk provon se është i pajisur me leje Mjedisore lëshuar nga QKL, “Kodi III.1.B” “Për ndikimin në Mjedis”, larje dhe pastrim mjetesh motorike Stacion transferimi për mbetjet jo të rrezikshme, së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, duke mplotësuar kështu kërkesën për kualifikim, sipas pikës 2.3.3. Sa më sipër, KPP sqaron, se

mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik “Ed Konstruksion” SHPK nuk ka dorëzuar licensën e kërkuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK qëndron.

III.3. Në lidhje me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Fusha” SHPK dhe “Ed Konstruksion” SHPK, Komisioni gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, referuar gjykimit mësipërm në pikën III.2 rezulton se gjendja faktike dhe juridike e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Fusha” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit, objekt shqyrtimi, duke përmbushur qëllimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-58761-08-21-2025 me objekt “Shërbimi i Pastrimit në Bashkinë Dimal” me fond limit 127,318,776 (njëqind e njëzet e shtatë milion e treqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO mbi kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Fusha” SHPK dhe “Ed Konstruksion” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet duke i skualifikuar ato.

3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Rej” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

